

Vaksinim kundër gripit

A dëshiron të shmangësh gripin serioz dhe rrezikun për një varg sëmundjesh. A i përket ti një grupi të rrezikuar? A je ti mbi 65 vjeç? Atëherë ti duhet të vaksinohesh, para se virusi i gripit të sivjetëm të arrin në Blekinge. Vakcina mbron ndaj gripit serioz që mund të shkaktoj një varg sëmundjesh, p.sh. pneumoni (inflamacion në mushkëri).

Gripit shkaktohet nga virusi dhe është shumë ngjites. Virusit infekton përmes ajrit dhe shpërndahet, para së gjithash, nëse ndonjë i sëmurë kollitet ose teshtitë. Në Suedi sëmundja është më e zakonshme gjatë muajve të dimrit. Gripit i zakonshëm quhet edhe gripit sezonal.

Një pjesë mund të sëmuren seriozisht

Para së gjithash, nëse je i/e moshuar ose nëse i përket një grupi të rrezikuar për t'u sëmurë seriozisht nga gripit. Gati të gjithë të cilët vdesin nga gripit janë mbi 65 vjeç, ose kanë ndonjë rrezik të një sëmundje të fshehur. Prandaj rekomandojmë, para së gjithash, grupet e rrezikuara si dhe të moshuarit, që të vaksinohen, për çdo vit.

Në grupet e rrezikuara përfshihesh nëse

- je mbi 65 vjeç
- ke një sëmundje të zemrës ose të mushkërive
- ke një diabet që trajtohet vështirë si dhe ke vlera të larta të sheqerit në gjak
- ke imunitet të dobësuar ndaj infeksioneve, nga ndonjë arsye tjetër
- ke një sëmundje kronike të mëlçisë ose të veshkave
- ke dukshëm mbipeshë
- ke një sëmundje neuromuskulare që ndikon në frymëmarrjen
- ti je shtatzënë në fazën e fundit të shtatzënisë
- ti je fëmijë dhe ke disa pengesa funksionimi

Për vaksinimin

Një pjesë e madhe e atyre që vaksinohen, shmangin gripin. Nëse, megjithatë do të sëmuresh, vakcina zvogëlon simptomën dhe ti nuk sëmuresh aq shumë sikur ti nuk do të merrje vaksinën.

Shumica e vaksinave ndaj gripit janë të prodhuara nga vezët e pulave. Nëse ti je alergjik ndaj vezëve të pulave, ti duhet gjithmonë të këshillohesh me një mjek, para një vaksinimi eventual.

Kështu bëhet vaksinimi

Ti vaksinohesh ndaj gripit një herë, dhe vaksinimi përsëritet pas një viti. Ti merr zakonisht injeksionin në krah. Kontakto qendrën tënde shëndetësore, për të caktuar kohën.

Pas vaksinimit, ndonjëherë mund të skuqet dhe të ënjtet vendi i injektimit dhe mund të dhemb. Ndonjëherë mund të kesh ethe/zjarrmi. Shqetësimet zakonisht kalojnë brenda disa ditëve.

Kostoja

Vaksinimi kushton 340 korona. Nëse i ke mbushë 65 vjet, vaksinimi është falas.